

V E N D I M
Nr.70, datë 6.7.2001

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Zija Vuci,	Anëtar i “““
Gjergj Sauli,	Anëtar i “““
Alfred Karamuço,	Anëtar i “““
Kujtim Puto,	Anëtar i “““
Tefta Zaka,	Anëtare e “““
Petrit Plloçi,	Anëtar i “““
Sokol Sadushi,	Anëtar i “““
Kristofor Peçi,	Anëtar i “““

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 5.7.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapra çështjen nr.81 Akti që i përket:

KËRKUES:LEKË ÇUKAJ, me kandidat për deputet në zonën zgjedhore nr.2, përfaqësuar me deklaram nga avokat Gjin Progni.

SUBJEKTE TË INTERESUAR:

1. KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, përfaqësuar nga zoti Sokol Lamaj.
2. MARK KROQI, kandidat për deputet në zonën zgjedhore nr.2, përfaqësuar me prokurë nga vokat Adnor Shameti.
3. KOMISIONI I ZONËS ZGJEDHORE NR.2, përfaqësuar nga kryetari Ndue Dodaj.

O B J E K T I:

Shfuqizimi i pjesshëm i vendimit nr.007, datë 30.6.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjo i relatorin e çështjes Kristofor Peçi, kërkuesin dhe përfaqësuesin e tij, përfaqësuesit e subjekteve të interesuara dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr.007, datë 30.6.2001, ka vendosur të mos shpallë rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve në zonën nr.2 dhe t'i shpallë të pavlefshme zgjedhjet në 18 qendra votimi.

Kërkuesi ka pretenduar se vendimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për një pjesë të qendrave të votimit nuk është i drejtë, sepse në to zgjedhjet janë zhvilluar normalisht dhe është nxjerrë rezultati nga komisioni i zonës.

Gjykata Kushtetuese çmon se kërkesa e tij është e drejtë dhe duhet pranuar. Komisioni i Zonës Zgjedhore nr.2, me vendimin nr.9, datë 26.6.2001, ka vendosur që të ribëhen zgjedhjet në 5 qendrat e votimit. Ky vendim është nënshkruar rregullisht nga i gjithë komisioni. Ndërsa me vendimin nr.10 të po kësaj date, Komisioni i Zonës ka njohur rezultatin në të gjitha qendrat e tjera të votimit. Për më tepër, procesverbalet e qendrave të votimit janë nënshkruar nga shumica e anëtarëve dhe në to nuk ka asnjë vërejtje për parregullsi.

Në këto kushte, vendimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për pjesën që ka shtuar edhe qendra të tjera votimi për t'u përsëritur zgjedhjet, pa u konsultuar sipas ligjit me komisionin e zonës zgjedhore përkatëse, është i padrejtë dhe duhet shfuqizuar.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 131 të Kushtetutës, nenit 141 të Kodit Zgjedhor, si dhe neneve 66, 67 e 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

V E N D O S I:

- Pranimin e pjesshëm të kërkesës për shfuqizimin e vendimit nr.007, datë 30.6.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për pjesën që ka shpallur të pavlefshme rezultatet e zgjedhjeve në pesë qendra votimi të zonës nr.2 Shkodër dhe konkretisht në qendrat e votmit nr.11 dhe 13 të Komunës Shkrel, 1 dhe 6 të Komunës Pult dhe 8 të Komunës Temal.

- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.